

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.29.03.2021*

**29.03.2021
Ora 11:05**

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për miratimin e sasisë së fletëve të votimit që do të prodhohen për çdo qendër votimi, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve Z.Ilirjan Celibashi**
 - 2.Stafi KQZ: Y.Merkaj, M.Koja, N.Mezani, E.Allushi.**
- **Parti Politike: PSD, LSI, PDIU**

Z. I. Celibashi: Mirëdita, atëhere në seancën e sotme publike, kemi në rend dite shqyrtimin e këtyre projektvendimeve.

. Projektvendim për miratimin e sasisë së fletëve të votimit që do të prodhohen për çdo qendër votimi për zgjedhjet e Kuvendit të datës 25 Prill 2021.

. Projektvendimi për caktimin e partive politike që do të propozojnë antarin e tretë dhe të katërt të grupeve të numërimit të votave.

. Projektvendimi për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Cërrrik.

. Projektvendimi për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Mallakastër.

. Projektvendim për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Lezhë.


. Projektvendim për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Kavajë.

. Projektvendim për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Vau i Dejës.

. Projektvendim për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Lezhë.

Gjithashtu janë në rendin e ditës.

*Zbardhi materialin audio
Albana NDOCI*



**Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.29.03.2021**

- . Projektvendimi për një shtesë në vendimin nr. 45 datë 09.02.2021 për miratimin e vëzhguesve afatgjatë të shoqatës për kulturë Demokratike.
- . Projektvendimi për miratimin e gazetarëve të qendrës Media Center Albania, portalit Alba News, Light Studio Agency, televizionit Vizion Plus, televizionit Media Nord për vëzhgimin e zgjedhjeve për Kuvend të datës 25 Prill 2021.
- . Projektvendim për miratimin e vëzhguesve afatgjatë dhe afatshkurtër të fondacionit, Instituti Shqipëtar për zhvillimin e sistemeve zgjedhore.
- . Projektvendim për miratimin e vëzhguesve afatgjatë të rrjetit European të organizatave të monitorimit të zgjedhjeve.
- . Projektvendimi që ka të bëjë me një ndryshim në vendimin nr.148 datë 16.03.2021, të Komisionerit Shtetëror “Për caktimin e vendit të numërimit të votave për zgjedhjet për Kuvend të Shqipërisë të datës 25 Prill 2021”.

Këto janë pikat e rendit të ditës! Po, përfaqësuesi i Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim.

Z. A. Kaziaj, Përfaqësues i LSI-së: Përshëndetje të gjithëve, ne kishim një kërkesë paraprake, ashtu si e relatuat edhe ju zoti kryetar. Sot në pikën e dytë, të rendit të ditës parashikohet shqyrtimi dhe miratimi i projektvendimit për caktimin e partive politike që do të propozojnë antarin e tretë dhe të katërt të grupit të numërimit të votave për Zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021. Duke ju kërkuar kohë për t’u vlerësuar akti nga ana jonë, kërkojmë shtyrjen në një datë të mëvonshme në mënyrë që të na jepet koha e mjaftueshme për t’u konsultuar me aktin dhe për të dhënë mendimet tona me shkrim.

Z. I. Celibashi: Po faleminderit, po përfaqësuesi i partisë PDIU.



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.29.03.2021*

Z.Sh.Sulo, përfaqësues i PDIU-së: Jam i mendimit që ky projektakt të kaloj sot në këtë komision për faktin sepse dhe përpara me sa di unë, para 1 muaji ka qenë ky projekakt për t'u diskutuar është shtyrë, është hequr nga rendi i ditës. Materiali ka qenë në dispozicion të partive politike që ditën e premte të javës së kaluar dhe në frymën e ligjit mendoj se nuk ka ndonjë gjë për t'u saktësuar apo për t'u diskutuar në lidhje me këtë projektakt, prandaj ne kërkojmë zoti Komisioner që të shqyrtohet sot, faleminderit.

Z. I. Celibashi: Diskutime të tjera lidhur me rendin e ditës? Me listën, me çështjet që janë në rendin e ditës? Nuk kemi! Mirë, unë mendoj që të respektojmë traditën. Kur një subjekt zgjedhor ka kërkuar kohë pak më shumë edhe pse është e vërtetë ajo që thatë, që ky akt ka ditë dhe kohë që ju është dërguar partive politike. Por, për sa kohë që një prej subjektve zgjedhor kërkon më shumë kohë për të vlerësuar përmbajtjen e këtij akti. Unë mendoj që duhet ta pranoj dhe do ta pranoj kërkesën për ta shtyrë dhe ndoshta në seancën e ditës së nesërme ose të pasnesërme, të mërkurën kur do të kemi një seancë tjetër publike të Komisionerit do ta shqyrtojmë. Besoj se është kohë e mjaftueshme për ta riparë edhe njëherë, faleminderit! Atëherë fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës që ka të bëjë me: projektvendimin "Për miratimin e sasisë së fletëve të votimit që do të prodhohen për çdo qendër votimi", po zoti sekretar!

Z.Y.Merkaj: Neni 19 pika 4 e Kodit Zgjedhor, theksohet se sasia e fletëve të votimit është e barabartë me numërin e zgjedhësve duke i shtuar 2%. Në nenin 99 pika 1 të Kodit Zgjedhor theksohet se KQZ dërgon në selitë e KZAZ-ve të ndara në kuti të veçanta për çdo qendër votimi. Veç të tjerash dhe numërin e nevojshëm

*Zbardhi materialin audio
Albana NDOCI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.29.03.2021*

të fletëve të votimit, në përputhje me numërin e zgjedhësve të regjistruar në atë qendër votimi, së bashku me numërin shtesë. Neni 10 i Udhëzimit nr.1 të viti 2021 të Komisionit Rregullator, ka përcaktuar afate dhe mënyrën e dërgimit të të dhënave për numërin përkatës të zgjedhësve për çdo qendër votimi. Duke qenë se Kodi Zgjedhor përcakton 35 ditë para datës së zgjedhjeve të dërgohen nga kryetarët e bashkive. Jo të gjithë kryetarët e bashkive kanë sjellë të dhënat për qendrat e votimit. Në këto kushte, jemi referuar Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile me të dhënat që ka sjell për çdo qendër votimi. Shkresa e fundit e Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile është e datës 19.03.2021 me nr. protokollin 2276. Nga përfundimi i të dhënave rezulton se në rang vendi janë gjithsej 5199 qendra votimi dhe gjithsej 3.588.869 zgjedhës. Bazuar në urdhërimet e pikës 4, të nenit 97 të Kodit Zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë datë 25 Prill 2021. Sasia e fletëve të votimit që duhet prodhohet duke shtuar dhe 2% mbi numërin e zgjedhësve është 3.660.647 fletë votimi gjithsej. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, si dhe listën e zgjedhësve të ndara për çdo qendër votimi.

Z. I. Celibashi: Përfaqësuesit e subjekteve zgjedhor?! Diskutime lidhur me këtë pikë të rendit të ditës? Jemi dakord! Atëherë bazuar në nenin 19, paragrafët 1 germa “n” dhe 2. Neni 97 paragrafi 4, dhe neni 99 paragrafi 1 germa “a”, të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë vendos:

1. Të miratoj sasinë e fletëve të votimit, që do të prodhohen për çdo qendër votimi, për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021, sipas lidhjes 1 bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së.

3. Kundër të këtij vendimi mund të bëhet ankimim brenda 3 ditëve në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

Vendimi nr.180

Zbardhi materialin audio

Albana NDOCI



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.29.03.2021*

29.03.2021
Ora 11:12

RENDI I DITËS

Projekvendim “Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Cërrik me kandidatin nga lista shumemërore të Partisë Socialiste e Shqipërisë Znj. Migena Albert Shima”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z.Ilirjan Celibashi**
 - 2.Stafi KQZ: **Y.Merkaj, M.Koja, N.Mezani, E.Allushi.**
- **Parti Politike: PSD, LSI, PDIU**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës.

Z.Y.Merkaj: Këshilli i Bashkisë Cërrik ka njoftuar KQZ për krijimin e vakancës, nga Këshilltari Mirjan Çabja, propozuar nga subjekti politik Partia Socialiste. Referuar nenit 164 të Kodit Zgjedhor, kandidati vijues nga lista shumemërore i Partisë Socialiste që i kalon mandati i Këshilltarit është kandidati me numër rendor 20 zonja Migena Shima. KQZ i është drejtuar për plotësimin për dorëzimin e formularit të vetëdeklarimit dhe kandidati për anëtar të Këshillit Bashkiak ka depozituar në KQZ formularin e vetëdeklarimit. Referuar nenit 11, të ligjit të dekriminalizimit, verifikimi dhe vetëdeklarimi kryhet për çdo kandidat të listës shumemërore për zgjedhjet pararendëse për këshillin e bashkisë të cilit i takon të marrë vendin e mbetur vakant. Kandidati ka depozituar formularin e deklarimit, Nga verifikimi formularit të deklarimit konstatohet se nuk ka deklaruar të dhëna

*Zbardhi materialin audio
Albana NDOCI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.29.03.2021*


për Gjendjen Gjyqësore. Gjithashtu KQZ ka dërguar kërkesë zyrës së Gjendjes Civile, zyrës së Gjendjes Gjyqësore, ku në përgjigje të kërkesës tonë Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile nuk ka kthyer ende përgjigje, ndërsa Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore pasi ka bërë verifikimin e Gjendjes Gjyqësore rezulton se nuk ka shënime në sistem. Në këto kushte konstatohet se të dhënat e kandidatit për anëtar të Këshillit të Bashkisë Cërrik, Znj.Migena Shima nuk përbëjnë kushte për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e këshilltarit. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit, përfaqësues të subjekteve zgjedhor? Nuk kanë diskutime! Atëhere, bazuar në nenin 19 e vijues të Kodit Zgjedhor vendos:

1. Zonja Migena Albert Shima, kandidat për anëtar në Këshillin e Bashkisë Cërrik nuk përfshihet në kushtet e moszgjedhjes për ushtrimin e funksionit.
2. Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Cërrik me kandidatin nga lista shumëmemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë Znj. Migena Albert Shima.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 ditëve, nga dita e hyrjes së tij në fuqi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së

Vendimi nr.181

*Zbardhi materialin audio
Albana NDOCI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.29.03.2021*

1. Atëherë, zonja Nartida Dritan Aliaj, kandidat për anëtar në Këshillin e Bashkisë Mallakastër, nuk përfshihet në kushtet e moszgjedhjes për ushtrimin e funksionit.
2. Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Mallakastër, me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Demokratia Sociale, zj. Natirda Dritan Aliaj.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Vendimi nr. 182

*Zbardhi materialin audio
Ardita VRIONI*



**Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.29.03.2021**

1. Atëherë, zj.Elsa Gjergj Gazulli, kandidat për anëtar në këshillin e bashkisë Lezhë, nuk përfshihet në kushtet e moszgjedhshmërisë për ushtrimin e funksionit.
2. Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Lezhë, me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Socialiste e Shqipërisë, zj. Elsa Gjergj Gazulli.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga hyrja e vendimit.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Vendimi nr. 183

**Zbardhi materialin audio
Ardita VRIONI**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.29.03.2021*

**29.03.2021
Ora 11:19**

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Kavajë, me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë G99, z.Mynyr Tahir Bekshiu”.


PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve Z.Illirjan Celibashi**
 - 2.Stafi KQZ: Y.Merkaj, M.Koja, N.Mezini, E.Allushi**
- **Parti Politike: LSI, PDIU, PSD**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës!

Z. Y. Merkaj: Këshilli i Bashkisë Kavajë, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga këshilltari, z.Aldo Duro, propozuar nga Subjekti politik Partia Socialiste e Shqipërisë. Për plotësimin e vakancës vendi i kandidatit i takon Partisë Socialiste duke qenë se në Këshillin e Bashkisë Kavajë ka shteruar lista e Partisë Socialiste. Atëherë, në bazë të nenit 164 pika 4 të Kodit Zgjedhor i takon anëtares së koalicionit e cila ka shteruar mandatin dhe anëtari i koalicionit me hersin më të lartë është partia e koalicionit, Partia G 99. Në këto kushte kandidati të cilit i takon të marrë vendin e mbetur vakant është kandidati i propozuar nga Partia G 99 është zoti Mynyr Bekshiu. I cili ka dorëzuar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularin e vetëdeklarimit dhe nuk ka deklaruar asnjë të dhënë nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit dhe nga përgjigja e ardhur nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore rezulton se

**Zbardhi materialin audio
Ardita VRIONI**



**Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.29.03.2021**

nuk ka shënime në sistem. Në këto kushte të dhënat e kandidatit për anëtar të Këshillit të Bashkisë Kavajë zotit Mynyr Bekshiu nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e tij në funksionin e këshilltarit. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim si dhe dokumentacionin përkatës.

Z. I. Celibashi: Faleminderit!

1. Atëherë, Z. Mynyr Tahir Bekshiu, kandidat për anëtar në Këshillin e Bashkisë Kavajë, nuk përfshihet në kushtet e moszgjedhshmërisë për ushtrimin e funksionit.
2. Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Kavajë, me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë G 99, z. Mynyr Tahir Bekshiu.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Vendimi nr. 184

**Zbardhi materialin audio
Ardita VRIONI**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.29.03.2021*

Këshillin e Bashkisë Vau i Dejës nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e tij në funksionin e këshilltarit, për Këshillin e Vaut të Dejes.

Z. I. Celibashi: Faleminderit!

1. Atëherë, Z. Nin Mark Curej, kandidat për anëtar në këshillin e bashkisë Vau Dejës, nuk përfshihet në kushtet e moszgjedhshmërisë për ushtrimin e funksionit.
2. Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Vau Dejës, me kandidatin nga lista shumëmemërore e Partisë Socialdemokrate e Shqipërisë, z. Nin Mark Curej.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Vendimi nr. 185

*Zbardhi materialin audio
Ardita VRIONI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.29.03.2021*

Lezhë zotit Visar Alia nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e tij në funksionin e këshilltarit. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim si dhe dokumentacionin përkatës, faleminderit.

Z. I. Celibashi: Faleminderit!

1. Atëherë, Z. Visar Pashk Alia kandidat për anëtar në Këshillin e Bashkisë Lezhë, nuk përfshihet në kushtet e moszgjedhshmërisë për ushtrimin e funksionit.
2. Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Lezhë, me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Socialiste e Shqipërisë, z. Visar Pashk Alia.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Vendimi nr. 186

*Zbardhi materialin audio
Ardita VRIONI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.29.03.2021*

29.03.2021
Ora 11:23

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për një shtesë në vendimin nr.45, datë 09.02.2021 “Për miratimin e vëzhguesve afatgjatë të Shoqatës për Kulturë Demokratike, për vëzhgimin e zgjedhjeve për Kuvend, të datës 25 prill 2021”.

PJESËMARRJA :

• **KQZ**

1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z.Illirjan Celibashi**

2.Stafi KQZ: **Y.Merkaj, M.Koja, N.Mezini, E.Allushi**

• **Parti Politike: LSI, PDIU, PSD**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës.

Z. Y. Merkaj: KQZ me vendimin nr.45 datë 09.02.2021 ka miratuar listën e vëzhguesve për akreditimin e 34 vëzhguesve afatgjatë si dhe zonat e vëzhgimit të tyre të Shoqatës për Kulturë Demokratike. Kjo organizatë ka depozituar pranë KQZ-së kërkesën për akreditimin e emrave edhe të 14 vëzhguesve afatgjatë si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Nga shqyrtimi i dokumentacionit, KQZ vëren se ai është i plotë dhe në përputhje me nenin 6 të Kodit Zgjedhor si dhe nenit 4 të Udhëzimit nr.2 të 2021, të KQZ-së. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, si dhe listën e vëzhguesve afatgjatë, faleminderit.

*Zbardhi materialin audio
Silvi SINO*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.29.03.2021*

Z. I. Celibashi: Atëherë, në vendimin nr.45, datë 09.02.2021 “Për miratimin e vëzhguesve afatgjatë të Shoqatës për Kulturë Demokratike, për vëzhgimin e zgjedhjeve për Kuvend, të datës 25 prill 2021 vendos:

1. Në listën përcaktuar lidhjes 1 bashkëlidhur këtij vendimi të shtohen 14 vëzhgues afatgjatë;
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së.

Vendimi nr.187

*Zbardhi materialin audio
Silvi SINO*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.29.03.2021*

**29.03.2021
Ora 11:24**

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për miratimin e gazetarëve të qendrës “Media Center Albania”, portalit “Alba news”, “Light Studio Agency (LSA), televizionit “Vizion Plus”, televizionit “Media Nord”, për vëzhgimin e zgjedhjeve për Kuvend, të datës 25 prill 2021”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z.Illirjan Celibashi**
2.Stafi KQZ: **Y.Merkaj, M.Koja, N.Mezini, E.Allushi**
- **Parti Politike:** **LSI, PDIU, PSD**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës.

Z. Y. Merkaj: Qendra “Media Center Albania” ka depozituar pranë KQZ-së kërkesën për akreditimin e 5 gazetarëve si dhe zonat e vëzhgimit të tyre, portali “Alba news” kërkesën për akreditimin e 2 gazetarëve si dhe zonat e vëzhgimit të tyre , “Light Studio Agency (LSA) kërkesën për akreditimin e 2 fotografëve si dhe zonat e vëzhgimit të tyre, televizioni “Vizion Plus” kërkesën për akreditimin e 86 gazetarëve si dhe zonat e vëzhgimit të tyre, televizioni “Media Nord” kërkesën për akreditimin e 13 gazetarëve si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Nga shqyrtimi i dokumentacionit, KQZ vëren se ai është i plotë dhe në përputhje me nenin 6 të Kodit Zgjedhor si dhe nenit 4 të udhëzimit nr.2 të 2021, të KQZ-së. Bashkëlidhur

**Zbardhi materialin audio
Silvi SINO**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.29.03.2021*


keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, si dhe listën e vëzhguesve, faleminderit.

Z. I. Celibashi: Atëherë, miratohet:

1. Kërkesa e “Media Center Albania” për akreditimin e 5 gazetarëve si dhe zonat e vëzhgimit të tyre, për vëzhgimin e zgjedhjeve për Kuvend, të datës 25 prill 2021, sipas listës së lidhjes “1” bashkëlidhur këtij vendimi;
 2. Kërkesa e portalit “Alba news” për akreditimin e 2 gazetarëve si dhe zonat e vëzhgimit të tyre, lista sipas lidhjes “2” bashkëlidhur këtij vendimi;
 3. Kërkesa e “Light Studio Agency (LSA)” për akreditimin e 2 fotografëve si dhe zonat e vëzhgimit të tyre sipas lidhjes “3” bashkëlidhur këtij vendimi;
 4. Kërkesa e televizionit “Vizion Plus” për akreditimin e 86 gazetarëve si dhe zonat e vëzhgimit të tyre sipas lidhjes “4” bashkëlidhur këtij vendimi,
 5. Kërkesa e televizionit “Media Nord” për akreditimin e 13 gazetarëve si dhe zonat e vëzhgimit të tyre sipas lidhjes “5” bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së.

Vendimi nr.188

*Zbardhi materialin audio
Silvi SINO*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.29.03.2021*

**29.03.2021
Ora 11:26**

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për miratimin e vëzhguesve afatgjatë të fondacionit “Instituti Shqiptar për Zhvillimin e Sistemit të Zgjedhjeve”, për vëzhgimin e zgjedhjeve për Kuvend, të datës 25 prill 2021”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve Z.Illirjan Celibashi**
 - 2.Stafi KQZ: Y.Merkaj, M.Koja, N.Mezini, E.Allushi**
- **Parti Politike: LSI, PDIU, PSD**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës.

Z. Y. Merkaj: Fondacioni “Instituti Shqiptar për Zhvillimin e Sistemit të Zgjedhjeve” ka depozituar në KQZ kërkesën për akreditimin e 15 vëzhguesve afatgjatë dhe 73 vëzhguesve afatshkurtër si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Kërkesa e paraqitur respekton afatin kohor të nenit 6, pika 5 të Kodit Zgjedhor. Nga shqyrtimi i dokumentacionit, KQZ vëren se ai është i plotë dhe në përputhje me nenin 6 të Kodit Zgjedhor si dhe nenit 4 të udhëzimit nr.2 të 2021, të KQZ-së. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, si dhe listën e vëzhguesve afatgjatë dhe afatshkurtër të këtij fondacioni, faleminderit.

Z. I. Celibashi: Atëherë, miratohet:

**Zbardhi materialin audio
Silvi SINO**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.29.03.2021*

1. Kërkesa e fondacionit “Instituti Shqiptar për Zhvillimin e Sistemit të Zgjedhjeve” për akreditimin e 15 vëzhguesve afatgjatë dhe 73 vëzhguesve afatshkurtër si dhe zonat e vëzhgimit të tyre, për vëzhgimin e zgjedhjeve për Kuvend, të datës 25 prill 2021 sipas lidhjes “1” dhe “2” bashkëlidhur këtij vendimi;
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së.

Vendimi nr.189

*Zbardhi materialin audio
Silvi SINO*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.29.03.2021*

tyre, për vëzhgimin e zgjedhjeve për Kuvend, të datës 25 prill 2021 sipas lidhjes
“1” bashkëlidhur këtij vendimi;

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së.

Vendimi nr.190

*Zbardhi materialin audio
Silvi SINO*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.29.03.2021*

**29.03.2021
Ora 11:27**

RENDI I DITËS

**Projektvendim “Për një ndryshim në vendimin nr.148, datë 16.03.2021
“Përcaktimin e Vendit të Numërimit të Votave, për zgjedhjet për Kuvendin e
Shqipërisë, të datës 25 prill 2021”.**

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z.Illirjan Celibashi**
2.Stafi KQZ: **Y.Merkaj, M.Koja, N.Mezini, E.Allushi**
- **Parti Politike:** **LSI, PDIU, PSD**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës.

Z. Y. Merkaj: KQZ me vendimin nr.148 datë 16.03.2021 ka caktuar ndër të tjera sipas lidhjes nr.1 dhe Vendin e Numërimit të Votave për KZAZ nr.3, që është caktuar në palestrën e Shkollës “Arben Broci” në Shkodër. Prefekti i Qarkut Shkodër ka paraqitur kërkesën datë 23.03.2021 për ndryshimin e kësaj VNV-je duke propozuar palestrën e Shkollës “Shenjazi Juka” duke komentuar se ndodhet në distancë më të afërt me qendrat e votimit. Ka hapësirë më të përshtatshme për të përmbushur masat anti Covid dhe kushte më të favorshme për numërimin e votave. Në këto kushte i propozojmë Komisionerit të pranojë kërkesën apo propozimin e prefektit për të ndryshuar Vendin e Numërimit të Votave të KZAZ nr.3, nga Shkolla “Arben Broci” në Shkollën “Shenjazi Juka”, faleminderit.

**Zbardhi materialin audio
Silvi SINO**



**Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.29.03.2021**

Z. I. Celibashi: Ne si KQZ kemi bërë verifikim në lidhje me këtë vendndodhje të re të propozuar?

Z. Y. Merkaj: Me sa di unë, inspektori i qarkut dhe KZAZ-ja nr.3 ka bërë inspektimin dhe plotëson kushtet.

Z. I. Celibashi: Përfaqësuesit e partive politike? S'kanë. Atëherë, miratohet:

1. Ndryshimi i Vendit të Numërimit të Votave për KZAZ nr.3, nga palestra e Shkollës "Arben Broci" në palestrën e Shkollës "Shenjazi Juka";
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së;
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 ditëve ne Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.

Vendimi nr.191

**Zbardhi materialin audio
Silvi SINO**



**Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.29.03.2021**

pa vendim përfundimtar të procedurës adminstartive të shqyrtimit të rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për ish funksionarin publik Ermal Etem Hasimaj në zbatim të ligjit nr.138 të vitit 2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike.

Z. I. Celibashi: Atëherë:

1. Deklarohet e përfunduar procedura administrative pa vendim përfundimtar për shkak të dorëheqjes së zotit Ermal (Agustin) Tetem Hasimaj, nga funksioni i anëtarit të këshillit bashkiak, Mallakastër;
 2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 ditëve në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve;
 3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së.
- Mëqenëse nuk kemi çështje të tjera në këtë seancë publike, e deklarojë atë të mbyllur.

Z. Sh. Sulo, përfaqësues i PDIU-së: Zoti kryetar, faleminderit. Meqenëse ditën e nesërme dhe pasnesërme, unë nuk ndodhem në Tiranë nëse është e mundur për mbledhjen që u la për caktimin e anëtarit mund të vendoset pas orës 16:00 si nesër dhe pasnesër, jo paradite? Faleminderit.

Z. I. Celibashi: Po patjetër, faleminderit dhe ditë të mbarë!

Vendimi nr.192

**Zbardhi materialin audio
Silvi SINO**

